



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2030/2 prot.,

Datë 23.07.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-06685-05-27-2024, me objekt: “Loti 5: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij””, me fond limit 14,480,108.25 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.

Ankimues:

Operatori ekonomik “4 S” SHPK me NIPT L64425401K dhe adresë: lagjja Xhevdet Nepravishta, Rruga Qerim Arapi, Zona Kadastrale 8571, Godina 196, Pasuria nr.23/104-N4, Lushnje.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier
Lagja “29 Nentori”, Rruga “Kastriot Muço”, Fier.

Në datën 22.07.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4358, si dhe nr.2030/2024 prot, datë 22.07.2024 i operatorit ekonomik “4 S” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me nr. REF-06685-05-27-2024, me objekt: “Loti 5: “Blerje mish dhe nënproduktet e tij””, me fond limit 14,480,108.25 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 27.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Ekonomike e Arsimit Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “4 S” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”, Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “4 S” SHPK.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi shqyrtoi dhe verifikoi dokumentacionin ligjor, ekonomik dhe teknik, të paraqitur në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës 4 S SHPK me NUIS L64425401K, konstatoi mangësit si më poshtë:

Referuar Shtojcës 7 të DST-së përcaktohet se Operatoret ekonomike të cilat do të paraqesin ofertat/ konkurrojnë për me shumë se një lot, duhet të plotesojnë kriteret e veçanta, xhiron vjetore sipas pikës 2.2.2., dhe përvorjen e ngjashme sipas pikës 2.3.1. si shumë të loteve për të cilat konkurrojnë.

Operatori ekonomik 4 S SHPK rezulton të ketë ofertuar në tre lote.

Konkretisht:

-Loti 1: “Blerje bulmeti dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kërkohej: “Për të provuar përvorjen e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 9 000 000 leke pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 1), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

-Loti 3: “Blerje bukë” ku sipas pikës 2.3.1 kërkohej: “Për të provuar përvorjen e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 1 000 000 leke pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 3), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

-Loti 5: “Blerje mishi dhe nënproduktet e tij” ku sipas pikës 2.3.1 kërkohej: “Për të provuar përvorjen e mëparshme, kërkohen dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në këtë rast vlera e kërkuar është jo më pak se 5 000 000 leke pa TVSH (e cila është një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet – për Lotin 5), që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.”

Në përmbushje të këtij kriteri OE 4 S SHPK ka ngarkuar në SPE fatura vlera e të cilave nuk e arrin shumën e loteve për të cilat ky operator ka konkurruar.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 22.07.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri